

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegj i përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N. F., nga fshati S., Komuna e P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati H. R. nga P., kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)–Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Drejtorinë e Gjendjes Civile, me bazë juridike anulimi i vendimit të organit të paditur, duke vendosur lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.159/2018 dt.21.11.2018, në seancën e mbajtur më datë 31.01.2019, mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e paditësit N. F., për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH. nr.159/2018 dt.21.11.2018.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.159/2018 dt.21.11.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit N. F., ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit administrativ A.nr.396/2016 dt.23.02.2018 me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit për anulimin e vendimit e të paditurës MPB-Komisioni për shqyrtimin e ankesave në Drejtorinë e Gjendjes Civile, nr...2015 datë

Kundër këtij aktgjykimi paditësi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që kërkesa të aprovohet, aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit AA UZH.nr.159/2018 dt.21.11.2018 dhe aktgjykimi i Departamentit Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A nr.396/2016 dt.23.02.2018 të ndryshohen, ashtu që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit, ose aktgjykimet e kontestuara të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Gjykata Supreme shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të kontestuar dhe kërkesës së parashtruar, në pajtim me nenin 53 të Ligjit për Konfliktin Administrativ (LKA), ka gjetur se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit AA.UZH. nr.159/2018 dt.21.11.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit N. F., ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti administrativ A. nr.396/2016 dt.23.02.2018.

me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit për anulimin e vendimit e të paditurës - MPB – Komisioni për për shqyrtimin e ankesave në Drejtorinë e Gjendjes Civile, nr...dt....

Duke bërë vlerësimin, Gjykata Supreme gjen se gjykata e shkallës së dytë drejt ka vendosur kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit, si të rregullt dhe të bazuar në Ligj në tërësi e aprovon edhe kjo Gjykatë, ngase aktgjykimi i kontestuar nuk është i përfshirë me shkelje, siç pretendon paditësi në kërkesë.

Me kopjen e librit amë të të lindurve nr.... të lëshuar nga Komuna e P. është vërtetuar se paditësi N. F. është i lindur me dt... në P., nga i ati I.dhe nëna H. F.. Nga kopja e librit amë të të lindurve me nr... të lëshuar nga Komuna e P., gjykata gjenë se N. F. ka lindur me dt... në fshatin S.I në Komunën e P., regjistrim ky i bërë në bazë të librezës shëndetësore nr.... Poashtu, edhe në shkollën fillore në fshatin S. paditësi është i regjistruar si i lindur me dt.... Gjithashtu, edhe në pasaportën e lëshuar nga Konzullata e ish Jugosllavisë në Frankfurt të R.Gjermanisë, me datën ..., gjykata gjenë se ditëlindja e paditësit është me datën

Prandaj, kjo Gjykatë konsideron se janë të pabazuara pretendimet e palës paditëse, sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë. Aktgjykimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm, përmbanë arsye të mjaftueshme dhe faktet vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme. Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit dhe është bërë aplikimi i drejtë të drejtës materiale.

Mbi këto arsye, në kuptim të nenit 54 par.1 të (LKA-së), Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

ARJ-UZVP.nr.16/2019 dt.31.01.2019

Kryetari i kolegjit,

Nebojsa Boriçiq

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Përktheu: F. A.